

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN ZHARRËZ, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Zharrëz , Fier, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë së komunës etj”. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 177, datë 30.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1167/8, datë 30.12.2012, dërguar z. **Taulant GREMI**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, plani strategjik, të përcaktohen objektivat, hartohen plan veprimet afatshkurta, të nënshkruhet Akt-Marrëveshja Tip “Për realizimin e Shërbimit të Auditimit të Brendshëm”, ndërmjet komunës dhe Prefektit të Qarkut Fier, si dhe të përcaktohen objektivat, hartohet e miratohet deklarata e misionit dhe vizionit, të Njësisë, të përcaktohen e mbahen në konsideratë risqet gjatë hartimit të objektivave afatmesme (PBA) në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”, ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe udhëzimit nr. 12, datë 5.6.2012 “Mbi Procedurat e Kryerjes së Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Menjëherë

2. Të hartohet strategjia e zhvillimit ekonomik dhe sektorial, të ngrihen ekipet përkatëse të menaxhimit, të merren në konsideratë këto dokumente për hartimin e PB-ve dhe PBA-ve në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”, si dhe të sigurohet evidentim i saktë, zbatim i njëjtë për buxhetin vendor dhe qendror, në zbatim të ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", i ndryshuar dhe ligjin nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”.

Vazhdimisht

3. Të hartohet e miratohet Rregullorja e Funksionimit dhe Organigrama e Komunës në përputhje me Strukturën Organizative e harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, si dhe të përcaktohen detyrimet ndaj Drejtorisë ekonomike, ndaj ZMMT, Zyrës së Urbanistikës dhe Zyrës së Shërbimeve për Administrimin menaxhimin, vënien në efencë të aseteve, inventarizimin fizik, gjendjen teknike të aseteve të llojit, ndërtesa, troje, resurseve toka bujqësore, pyje kullota në zbatim të e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, nr. 10296, datë 8.7.2010.

Menjëherë

4. Këshilli i komunës të rishikojë emërtimin e pozicionit Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, pasi me numrin e kufizuar të punonjësve në strukturën aktuale një pozicion i tillë është i pa justifikuar, në zbatim të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Menjëherë

5. Komuna Zharrëz, të ndjek procedurën ligjore dhe të marrë në pronësi e administrim ujësjellësit që administrohen aktualisht nga kjo komuna në zbatim të akteve ligjore në njësit vendore.

Menjëherë

6. Këshilli i Komunës në përcaktimin e përvitshëm të shtesës së pagës së punonjësve të bazohet në numrin e banorëve të regjistrit të gjendjes civile, të vitit kalendarik, sipas VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

Menjëherë

7. Komuna Zharrëz, të vendos marrëdhëniet ligjore të punës, plotësojë me dokumentacion, kryej inventarizimin e dosjeve të personelit dhe në kontratat e punës të përcaktojë bazën ligjore dhe zgjidhjen në gjykatë të mosmarrëveshjeve, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit”.

Menjëherë

8. Komuna Zharrëz të investoj në IT, me programe për mbajtjen e kontabilitetit sipas si dhe vejë në funksion ditarin e veprimeve të ndryshme, plotësoj saktë librin e arkës në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 290, datë 14.06.1993.

Menjëherë

9. Komuna Zharrëz, në kryerjen e shpenzimeve për blerjet me vlera të vogla të zbatojë procedurat ligjore dhe të mbajë dokumentacioni përkatës, planifikimin e zbërthimin e shpenzimeve operative, regjistri e parashikimit dhe realizimit të prokurimit me blerje të vogla, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Menjëherë

10. Komuna Zharrëz të veçojë pozicionin e magazinierit nga përgjegjësi i financës për të shmang konfliktin e interesit, si dhe të zbatojë procedurat ligjore të marrjes dhe të nxjerrjes nga kontabiliteti, të vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të nxjerra jashtë përdorimit në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

Menjëherë

11. Komuna Zharrëz, të bëjë hyrje në magazinë ndihmat e ardhura nga Drejtoria Rajonale Arsimore Fier, në zbatim të VKM nr. 166, datë 11.4.1997 “Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës”.

Menjëherë

12. Komuna Zharrëz, të hartoj program të plotë vjetor për inventarizimin tërësor të pasurisë publike, program i cili të jetë konfidencial, të kryej inventarizimin e rastësishëm në periudhën e përcaktuar, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

Vazhdimisht

13. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me policinë e komunës të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitoare **530,210 lekë**, për 19 subjektet fizike të pa licencuara dhe të licencuara, të cilat nuk kanë shlyer detyrimet e taksave vendore për vitin 2011 dhe 2012.

Menjëherë

14. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me policinë e komunës të marrë masa për licencimin e 25 subjekteve fizike të cilat ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar.

Menjëherë

15. Të ngrihet grup pune për verifikimin dhe plotësimin me dokumentacionin për kondicionet urbanistike, si dhe të arkivohen dosjet e SUP, leje sheshi dhe leje ndërtimi, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

Menjëherë

16. Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), hartimin dhe miratimin e instrumenteve të planifikimit në nivel vendor, të Politikave të Zhvillimit të Territorit të Komunës (PZHNjV) si dhe miratimin e rregullores përkatëse për ti hapur rrugën zhvillimit të territorit në mënyrë të qëndrueshme, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Menjëherë

17. Komuna Zharrëz, të kontabilizojë vlerën prej **1,341,167 lekë**, të investimeve të kryera për 11 objekte e financuara me fondet e saj dhe të buxhetit dhe të shlyej detyrimin prej **16,765 lekë**, ndaj këshillit të Qarkut Fier në zbatim të ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 17.9.1999 “Për disiplinë e punimeve në ndërtim” dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”.

Menjëherë

18. Komuna Zharrëz të ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për saktësimin dhe bërjen e korrigjimeve në shtesë të sipërfaqes së Fushës së Sportit Sheqishtë për + 950 m² dhe në shtesë të sipërfaqes së Fushës së Sportit Zharrëz (Fshati i Ri) + 359 m² si dhe korrigjimin në pakësim të sipërfaqes së Fushës së Sportit Belinë për - 62 m², në zbatim të VKM nr. 367, datë 27.3.2008.

Menjëherë

19. Komuna Zharrëz të shqyrtojë në bashkëpunim me strukturat shtetërore, të përcaktojë dhe vërtetojë me dokumentet përkatëse kohën e ndërtimit të shtëpive në 14 rastet e paraqitura, sipas pasqyrës nr. 11, pretenduar si të ndërtuara në vitet 1991 dhe të analizojë e kërkojë të ardhurat e munguara nga mos vjelja e qirasë truallit në vlerën **5,630,340 lekë**. Gjithashtu për trojet e zëna me ngrahina jashtë sipërfaqes - normë për ndërtim shtëpie në fshat, të merren masa për pagesën e qirasë dhe lirim të truallit të zënë tepër.

Menjëherë

20. Komuna Zharrëz të analizojë të ardhurat e munguara në vlerën prej **1,239,560 lekë** dhe të nisi procedurat ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshme të sipërfaqeve të trojeve të fushave të sportit dhe asaj të fshatit Belinë, me shpenzimet e dëmtuesve.

Menjëherë

21. Të kryhet inventarizimi fizik, të përfshihen në inventarin kontabël dhe librin e AQT-ve, të evidentohet e raportohet gjendja aktuale fizike dhe të vihen në efencë pronat e paluajtshme (Asete) asetet e llojit ndërtesa, trojet dhe aksesorët përkatës të tyre nga të cilat 6 me funksion shëndetësor, 5 me funksion shërbimi funeral, 6 me funksion shërbimi mbrojtës sipas tabelave nr .12, 13, 14; si dhe asetet e tjera sipas listës në zbatim të VKM nr. 367, datë 27.3.2008 “Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Zharrëz të Qarkut të Fierit”.

Menjëherë

22. Komuna Zharrëz, të shqyrtojë dhe zgjidh në rrugë administrative dhe ligjore gjendjen e shpërndarjes së zërit kadastral “truall” për tokë bujqësore në sipërfaqen prej **11,600 m²** dhe të zbatojë sipas rastit procedurat për ndryshimin e kategorisë së resursit nga “truall” në kategorinë “Tokë bujqësore”, në zbatim të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010 ” Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8752, datë 28.03.2001 dhe akteve nënligjore.”.

Menjëherë

23. Komuna Zharrëz, të marrë në dorëzim nga DSHP Fier, me procesverbal të shoqëruar nga “Regjistri i ngastrave dhe nën/ngastrave sipas ekonomisë pyjore”, të inventarizojë fizikisht të vendosë nën administrim dhe efencë, të hartojë dhe zbatojë plane menaxhimi e mbarështimi, të kryejë inventarizim kadastral të fondit pyjor për evidentimin, përditësimin, përdorimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë mbrojtëse (të pyjeve mbrojtës) për sipërfaqen pyjore prej 83 ha, me 11 prona (nr. 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74), transferuar në pronësi, në zbatim të VKM nr. 410, datë 8.4.2008 “Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Zharrëz të Qarkut Fier” dhe të VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe Kriteve të Administrimit të Pyllit Komunal”.

Menjëherë

24. Komuna Zharrëz të rikonceptojë, rishkruaj sipas formës së duhur ligjore (kontratës- tip), ti noterizojë dhe regjistrojë në ZVRPP Fier 4 kontratat e qiradhënies me 13,400 m² tokë bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 8318, datë 26.03.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.

Menjëherë

25. Komuna Zharrëz, të rishikojë dhe të plotësojë strukturën me staf të kualifikuar, të hartojë dhe zbatojë programe pune të kombinuara me strukturat brenda dhe jashtë komunës si dhe të përdor blloqe gjobash me numër serie, të bashkëpunojë me INUK Qark, për objektet pa leje ndërtimi, zënie hapësira publike dhe ndotje ambienti, në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, të ndryshuar dhe Rregullores “TIP” të Policisë Bashkiake dhe të Komunës” nr. 1530, datë 07.04.2003”.

Menjëherë

26. Komuna Zharrëz, të zbatojë rregullat lidhur me ruajtjen, administrimin, dokumentimin, lëvizjen dhe qarkullimin e dokumenteve zyrtare, si dhe të arkivojë e vendos nën administrim dokumentet e munguara të ndodhura nëpër zyra, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit: për 6 raste në vlerën **47, 000 lekë**, përfituar padrejtësisht shpërblim me rastin e 8 marsit për vitin 2010-2011, për vlerën **37,980 lekë**, përfituar padrejtësisht për pushimit vjetor të pa kryer të vitit 2009, për vlerën **32,049 lekë**, përfituar padrejtësisht si pagë mbi kohën normale të punës, sipas pasqyrës nr. 4, për vlerën **6, 000 lekë** për shpenzime fjetje, për vlerën **113, 000 lekë**, përfituar në mënyrë të paligjshme shpërblim 3 punonjës nga fondi i veçantë i vitit 2010.

Menjëherë

2. Për vlerën **80,366 lekë** ndaj debitorëve pa shpresë arkëtimi.

Menjëherë

3. Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,677,206 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga zj. [REDAKTUAR] kryetare e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe nga znj. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR], anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkak të s’kualifikimit të gabuar të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k, në tenderin e zhvilluar në vitin 2012, me objekt “Rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Zharrëz”, i cili duhet të shpallej fitues pasi operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 4,104,082 lekë pa t.v.sh. ose **1,677,206 lekë** më pak se sa vlera e kontratës e shpallur fituese.

Menjëherë

4. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **36,400 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR], pasi në kundërshtim me UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ka përfituar padrejtësisht vlerën e t.v.sh. që i përket pajisjeve, në tenderin e zhvilluar në vitin 2012, me objekt “Rikonstruksion i shkollave të komunës”.

Menjëherë

5. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **9,100 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. pasi në kundërshtim me UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ka përfituar padrejtësisht vlerën e t.v.sh. që i përket pajisjeve, në tenderin e zhvilluar në vitin 2011, me objekt “Ndërtim Ambulancë Tipi A Fshati Beline”.

Menjëherë

6. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **196,248 lekë**, nga operatori ekonomikë “Spartaku”, pasi në kundërshtim me UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ka përfituar padrejtësisht vlerën e t.v.sh. që i përket pajisjeve, në tenderin e zhvilluar në vitin 2010, me objekt “Ndërtim montimi i sistemit të ndriçimit të rrugëve të fshatrave: Zharrëz, Fshati i Ri, Verbas, Frashër dhe Sheqishtë në komunën Zharrëz”, loti I.

Menjëherë

7. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **232,000 lekë**, nga operatori ekonomik [REDACTED] sh.p.k. pasi në kundërshtim me UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ka përfituar padrejtësisht vlerën e t.v.sh. që i përket pajisjeve, në tenderin e zhvilluar në vitin 2010, me objekt “Ndërtim montimi i sistemit të ndriçimit të rrugëve të fshatrave: Zharrëz, Fshati i Ri, Verbas, Frashër dhe Sheqishtë në komunën Zharrëz”, loti II.

Menjëherë

8. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **118,200 lekë**, nga operatori ekonomik [REDACTED] pasi në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, ka përfituar padrejtësisht vlerën e t.v.sh. që i përket pajisjeve, në tenderin e zhvilluar në vitin 2009, me objekt “Shtesë e shkollës së mesme Sotir Capo”.

Menjëherë

9. Të kërkohet në rrugë ligjor e arkëtimi i vlerës prej **23,800 lekë** ndaj 19 personave për tarifën e pastrimit të papaguar në vitin 2010 dhe 2011.

Menjëherë

10. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **107,137 lekë**, për taksën e ndërtesës të papaguar për vitin 2012 nga subjekti juridik [REDACTED].

Menjëherë

11. Komuna Zharrëz të kontabilizojë dhe të nisi procedurat ligjore për kërkimin ndaj [REDACTED] e vlerës së dëmit ekonomik në shumën **5,804,370 lekë** qira dhe kamatëvonesa të pa llogaritura dhe të pa arkëtuara, nga e cila **4,464,900 lekë**, niveli i qirasë dhe **1,339,470 lekë** kamatë vonesa nga përdorimi i sipërfaqes prej 726 m², si dhe kthimin e sipërfaqes së truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e dëmtuesit.

Menjëherë

12. Komuna Zharrëz të kontabilizojë dhe kërkojë në rrugë ligjore vlerën prej **48,824 lekë**, nga e cila qira 12,600 lekë dhe kamatëvonesë 36,824 lekë, sipas kontratave të lidhura për dhënien me qira të tokës bujqësore.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 141, 144 pika 2 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkoj Kryetarit të Komunës, të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore për personat si më poshtë:

I. “Vërejtje me paralajmërim”.

1. Për zj. [REDACTED] me detyrë Drejtore e Degës Ekonomike:

- Për moszbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me hartimin dhe zbatimin e planit strategjik dhe planet afat shkurtra, si dhe zbatimin e planit financiar dhe të kontrollit të brendshëm dhe mos menaxhimin e riskut.

- Për mangësi e shkelje në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”; ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010” i ndryshuar; ligjin nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” dhe udhëzimet përkatëse lidhur me hartimin e projekt buxheteve (mos përgatitjen e formularëve nr. 1 dhe nr. 2 të viti 2010-2011 2012, si dhe lidhur me mangësitë në zbatimin e buxheteve të secilit vit.

- Për shkeljet dhe mangësitë në zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, lidhur me veprimet me bankën mbajtjen e ditarëve, inventarizimin e pasurive, administrimin e shpenzimeve.

- Për mangësitë dhe shkeljet lidhur me zbatimin e ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërimit”, lidhur me prokurimet e shpenzimet për shërbime, mirëmbajtje, investime, mallra etj.

- në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e konstatuara në 1 tender të zhvilluar në vitin 2010 ë 3 tendera të zhvilluar në vitin 2012 në 1 tender të zhvilluar në vitin 2011 shoqëruar edhe me dëm ekonomik në shumën 2,269,154 lekë.

2. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë juriste:

-Për mangësi e shkelje në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Për mangësitë e shkeljet në hartimin dhe zbatimin e kontratave të dhënies me qira të tokës bujqësore.

- Për mangësitë e shkeljet ne tre raste, në zbatim të legjislacionit.

3. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse Finance dhe magazinierë:

- Për mangësi e shkelje në 7 raste; në zbatim të legjislacionit.

- Në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e konstatuara në 3 tendera të zhvilluar në vitin 2012”, shoqëruar edhe me dëm ekonomik në shumën 1,722,706 lekë.

4. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës:

- Për mungesë inventarizimi, kontrolli, mosvenie në eficientë dhe mosadministrim të aseteve troje, fusha sporti, ndërtesa, pyje-kullota, shkelje të dhënies me qira tokës bujqësore, mos vjelje të qerasë si dhe moslogaritje dhe përdorim të paligjshëm nga të tretët që kanë sjellë mungesë të ardhurash dhe përfitime nga të tretë.

- Për mangësitë e shkeljet të legjislacionit në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet me vlera të vogla dhe anëtare e komisionit të asgjësimit të vlerave materiale në 3 raste.

5. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Zyrës Tatim Taksave,

- Për parashikim e hartim me rezerva, mosmbledhje e mosrealizim, mosregjistrim e lejim të veprimtarisë subjekteve pa licenca, mosvendosje sanksionesh, mungesë ndjekje e kontrolli në terren re, mosvjelje debitorësh, të tarifave e taksave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë , të ndryshuar.

- Për mangësitë e shkeljet e legjislacionit në cilësinë e anëtarit të komisionit të asgjësimit të vlerave materiale në 2 raste.

-Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave , për shkeljet e konstatuara në 3 tendera të zhvilluar në vitin 2012 në 1 tender të zhvilluar në vitin 2010, dhe në 1 tender të zhvilluar në vitin 2009.

6. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë arkëtar,

- Për mangësitë e shkeljet e legjislacionit në cilësinë e anëtarit të komisionit të asgjësimit të vlerave materiale në 2 raste.

7. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor në Zyrën e Urbanistikës,

- Për mangësitë e shkeljet e legjislacionit në cilësinë e anëtarit të komisionit të asgjësimit të vlerave materiale në 2 raste.

8. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, përgjegjës i zyrës së urbanistikës ,

- Në cilësinë e sekretarit të KRRT-së për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar.

- Për mangësitë e shkeljet e legjislacionit në cilësinë e anëtarit të komisionit të asgjësimit të vlerave materiale në 1 raste; trajtuar në faqen 48-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

- Për mungesë inventarizimi, kontrolli, mosvënie në efikasitet dhe mosadministrim të aseteve troje, fusha sporti, ndërtesa, pyje-kullota, mosvjelje të qirasë si dhe mosllogaritje dhe përdorim të paligjshëm nga të tretët që kanë sjellë mungesë të ardhurash dhe përfitime nga të tretët.

9. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor policie,

- Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 i ndryshuar “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” nenet 3, 5, 7, 8, 13.

- Për mungesë inventarizimi, kontrolli, mosvënie në efikasitet dhe mosadministrim të aseteve troje, fusha sporti, ndërtesa, pyje-kullota, dhe përdorim të paligjshëm nga të tretët që kanë sjellë mungesë të ardhurash dhe përfitime nga të tretët.

10. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor policie,

- Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 i ndryshuar “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” nenet 3, 5, 7, 8, 13.

-Për mungesë inventarizimi, kontrolli, mosvënie në efikasitet dhe mosadministrim të aseteve troje, fusha sporti, ndërtesa, pyje-kullota, dhe përdorim të paligjshëm nga të tretët që kanë sjellë mungesë të ardhurash dhe përfitime nga të tretët.

11. - Për z. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor i Zyrës Taksave Vendore,

- Për parashikim e hartim me rezerva, mosmbledhje mosrealizim, mosregjistrim e lejim të veprimtarisë subjekteve pa licenca, mosvendosje sanksionesh, mungesë ndjekje e kontrolli në terren re, mos vjelje debitorësh, të tarifave e taksave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selfo Zeneli, Qemal Shehu, Milo Pano, Dorino Meço dhe Besim Bileri. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT